



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEQA"

SYLLABUSI I LËNDËS: MENAXHIMI I RISKUT TË INVESTIMEVE

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Biznesit
Titulli i lëndës:	Menaxhimi i Riskut të Investimeve
Niveli:	Master
Status i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Semestri dimëror
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	Menaxhimi i Riskut të Investimeve mund të studiohet si lëndë semestrale lidhur me elementet e investimeve, zgjedhjen e portfolios në funksion të riskut dhe kthimit, analizën dhe vlerësimin e letrave me vlerë dhe alternativat e tjera të investimeve. Kjo lëndë përbëhet prej tri pjesëve. Në pjesën e parë diskutohen investimet, tregjet financiare, llojet e letrave me vlerë dhe blerja – shitja e letrave me vlerë. Pjesa e dytë përmban thelbin e teorisë moderne të portfoliut dhe në pjesën e tretë trajtohen analiza dhe vlerësimi i letrave me vlerë dhe alternativat e tjera të investimeve.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i lëndës Menaxhimi i Riskut të Investimeve është që t'i pajisë studentët e nivelit master me njohuri të avancuara në fushën e menaxhimit të investimeve. Studentet të kuptojnë aspektet teorike, metodologjike dhe praktike të planifikimit dhe realizimit të menaxhimit të investimeve. Krijimi i dijeve dhe shkathtësive për të kuptuar dhe zbatuar metodat standarde ndërkombëtare të planifikimit dhe vlerësimit të investimeve.

Rezultatet e pritura të nxënies:	Përmes kësaj lënde, studentët e finances njihen me çështjet kryesore me të cilat përballen aktualisht të gjithë investuesit, si dhe pajisjen me aftësitë e nevojshme për kryerjen e një vlerësimi cilësor dhe sasior, jo vetëm të investimeve, por edhe të çështjeve kritike aktuale dhe të debateve të mbuluara nga media e përgjithshme, si dhe nga revistat me të specializuara të financës.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjerata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	10	20
Ushtrime në teren	2	10	20
Seminare, projekte, prezentimet,etj.	3	5	15
Koha e studimit vetanak të studentit	2	15	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	10	1	10
Përgaditja përfundimtare për provim	2	5	10
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies:	• Prezantimi i temës mësimore në Power Point • Përsëritja e temës paraprake nga grupi i caktuar i studentëve, analiza dhe diskutime • Rast studimi apo detyrë (për orën e ushtrimeve) lidhur me temën e ligjëruar		

Metodat e vlerësimit:	• Testi i parë vlerësues: 0 - 30% • Testi i dytë vlerësues: 0 - 30% • Punimi shkencor: 0 - 40% • Provimi përfundimtar: 0 - 60%
Literatura	
Literatura bazë:	▪ <i>Ligjerata të përgatitura nga profesori i lëndës në fushën e investimeve dhe menaxhimit të portofolios.</i> ▪ <i>Edlira Luçi & Dorina Kripa – Investime, Tiranë, Pegi, 2016. ISBN: 978-99943-693-1-8</i> ▪ <i>Edlira Luçi & Dorina Kripa – Investime (Teste, ushtrime dhe problema), Tiranë, Pegi, 2016. ISBN: 978-99943-40-95-8</i>
Literatura shtesë:	▪ <i>Zvi Bodie & Alex Kane & Alan Marcus – Investimet 1, Mediaprint, 2014</i> ▪ <i>Zvi Bodie & Alex Kane & Alan Marcus – Investimet 2, Mediaprint, 2014</i> ▪ <i>Sherif Bundo – Drejtim Portfoli, Botimi 1, AlbPaper 2007, ISBN: 9789995634100.</i>
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Hyrje (Prezantimi i lëndës, metodat e punës dhe vlerësimit)
Java e dytë:	Investimet dhe karakteristikat e tyre
Java e tretë:	Investitori dhe procesi investues
Java e katërt:	Tregjet financiare dhe funksionimi i tyre
Java e pestë:	Llojet e letrave me vlerë dhe karakteristikat e tyre
Java e gjashtë:	Blerja dhe shitja e letrave me vlerë
Java e shtatë:	Risku dhe kthimi në investime
Java e tetë:	Testi i parë vlerësues

Java e nëntë:	Ndërtimi i portofolit
Java e dhjetë	Modelet e vlerësimit të mjeteve – Modeli CAPM
Java e njëmbëdhjetë:	Karakteristikat dhe vlerësimi i obligacionit
Java e dymbëdhjetë :	Jetëgjatësia dhe konveksiteti i obligacionit
Java e trembëdhjetë:	Karakteristikat dhe vlerësimi i aksionit të zakonshëm
Java e katërbëdhjetë:	Kompanitë investuese dhe investimi në pasuritë e paluajtshme
Java e pesëmbëdhjetë:	Testi i dytë vlerësues Prezentimi i punimeve shkencore

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
<i>Cakto politikat e mirësjelljes konform statusit të UHZ-së.</i> • Para së gjithash, studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore; • Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore; • Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e indeksit dhe mjetit të identifikimit në teste dhe provim; • Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet të përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit; • Testet dhe provimet vlerësohen individualisht për secilin student. Prandaj, studentet duhet të përqëndrohen vetëm në njohuritë personale. • Shkelja eventuale e këtyre parimeve etike (rregullave) ndëshkohet konform normave të parapara me ligj.